



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.307, datë 21.11.2022

PËR

**“PEZULLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR TË FILLUAR NDAJ  
MAGJISTRATIT E.R ME DETYRË, PROKUROR NË  
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 145 në lidhje me nenin 126, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 184, germa “e” dhe 189, pika 1, germa “a” dhe pika 3, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe nenin 66, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Komisionit Disiplinor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pezullimin e procedimit disiplinor Nr.100/43, datë 21.10.2022, të filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjistratit E.R , prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë , sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Ky pezullim ka efekt deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit E.R , me vendim përfundimtar.
3. Ky vendim i njoftohet brenda 5 ditëve magjistratit E.R dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 21.11.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Eloida Goxhi

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Zeqir Hoda



**ANËTAR**  
**Mirela Bogdani**

**ANËTAR**  
**Arta Mandro**

**ANËTAR**  
**Ledina Riza**